



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0315**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Batisha Ibrahimimi dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE “Interlab” SH.P.K., kundër njoftimit për kontratë ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me produkte për personat paraplegjik dhe tetraplegjik” me numër të prokurimit 00220-24-2499-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS”, më 07/06/2024, mori këtë:

### **Vendim**

**1. Apropohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e “Interlab” SH.P.K., me nr.2024/0315, e datës 11/04/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me produkte për personat paraplegjik dhe tetraplegjik”, me numër të prokurimit 00220-24-2499-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS”

**2. Mbetet në fuqi**, njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me produkte për personat paraplegjik dhe tetraplegjik” me nr. të prokurimit: 00220-24-2499-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS”, AK mund të vazhdoj tutje me këtë aktivitet të prokurimit

**3. Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.** OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale --*

Me 19.03.2024, “SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me produkte për personat paraplegjik dhe tetraplegjik” me nr. të prokurimit: 00220-24-2499-1-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: - furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 6,500,000.00 €

Me 04.04.2024, OE “Interlab” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 08.04.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 11.04.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Interlab” SH.P.K., me nr. 2024/0315 për lidhur me aktivitetin “Furnizim me produkte për personat paraplegjik dhe tetraplegjik” me nr. të prokurimit: 00220-24-2499-1-1-1.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Interlab” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimet e OE ankues: - Pas pranimit të vendimit të refuzimit për kërkesën tonë për rishqyrtim vërehet qarte nga AK se vetëm se është munduar të krijoj mjegull për Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik. Një gjë mund të shihet qarte këtu se AK ka bërë trukimin e këtij aktiviteti të prokurimit publik duke tentuar që të bëhet keqpërdorim i mbi 3.5 Milion euro. Ndihe për personat me nevoja të veçanta dhe për Republikën e Kosovës do të ishte sikurse të krijohej specifikim i atillë ku nuk do të përpilohej specifikimi i tillë i përshtatur pike për pike për prodhuesin Hoggi dhe Invacare duke mundësuar trukimin e tenderit dhe keqpërdorimin e mbi 3.5M, nëse këto produkte do të bliheshin nga cilido prodhues Evropian me kualitetin e njëjtë, mirëpo kjo nuk është mundësuar nga AK pasiçë specifikimi është copy paste nga katalogu i Hoggi GmbH dhe Invacare për të cilën edhe AK është ne dijeni se asnjë prodhues në bote nuk prodhon të njëjta dimensione për modele të këtyre karrigeve. Që dmth secili prodhues ka dimensionet e veta dhe nuk i përmbush ato të kërkuara në DT.

- Për pozicionin nga 1 deri në 3 nuk ekziston asnjë prodhues në bote (Quicke, Sunrise Medical, B+B Medical, Panthera) që mund të i përmbush specifikimet 100% dmth dimensionet e kërkuar sipas DT.

- Fakti që AK këtë aktivitet të prokurimit publik e ka publikuar për një periudhë nga data e publikimit deri në datën e hapjes për vetëm 20 dite dhe duke kërkuar edhe moster në datën e hapjes atëherë edhe me shume forcon pretendimet tona se pas kësaj qëndron qëllimi i ngushtimit të konkurrencës në vetëm një operator ekonomik, dhe ofertimi deri në maksimum të buxhetit për këtë aktivitet të prokurimit publik. Specifikimet teknike favorizuese për OE “Madekos” sh.p.k

nga njësia e kërkesës.

Pretendim Ankimor-Specifikimet Teknike te Detyrueshme Aneksi 1-Favorizuese për prodhuesin HOGGI GmbH dhe modelin Bingo evolution për pozicionin 1-Karroce me mbështetje posturale – speciale për fëmijë te varur 100% ne karroce, për prodhuesin HOGGI GmbH dhe modelin Sherpa 3007 per pozicionin 2-Karroce me Mbështetje posturale- speciale për fëmijë aktiv, për prodhuesin HOGGI GmbH dhe modelin Supra 2.0 për pozicionin 3 Karroca për përdorim aktiv, për pozicionin 4,5,6 për prodhuesin invacare nga Anglia.- te përpiluara nga njësia e kërkesës janë përgatitur për Operatorin ekonomik “Madekos” sh.p.k.

Autoriteti kontraktues me datën: 20.03.2024 ne platformën e-prokurimit ka ngritur dosjen e te cilën pasi kemi analizuar kërkesat e përzgjedhjes dhe specifikimet teknike te dosjes se tenderit kemi ardhur ne konkluzion se ne TËRËSI- Specifikimet teknike te detyrueshme Aneksi 1 janë ne përputhje me produktet e prodhuesit HOGGI GmbH dhe modelin Bingo evolution për pozicionin 1- Karroce me mbështetje posturale - speciale për fëmijë te varur 100% ne karroce , për prodhuesin HOGGI GmbH dhe modelin Sherpa 3007 per pozicionin 2-Karroce me Mbështetje posturale- speciale për femije aktiv, për prodhuesin HOGGI GmbH dhe modelin Supra 2.0 për pozicionin 3 Karroca për përdorim aktiv dhe për pozicionet 4,5,6 për prodhuesin INVACARE nga anglia.

Praktike e thjeshte: Nëse merren copy-paste specifikimet teknike te detyrueshme dhe vendosen ne [www.google.com](http://www.google.com), menjëherë ndërlidhen me prodhuesit qe kemi cekur qe tregon haptas se janë favorizuese dhe kundërshtim me dispozitat e LPP-se.

Kërkesat e AK-se janë ne formën e kërkuar qe te gjitha karriget për përdormi tek personat paraplegjik dhe tetraplegjik janë fikse dhe është e pamundshme qe dy prodhues ne bote te kane dimensionet ekzaktë, dhe me këto kërkesa AK ka ngushtuar apo parapërcaktuar fituesin për këtë aktivitet te prokurimit publik.

Pozicioni 1- Karroce me mbështetje posturale – speciale për fëmijë te varur 100% ne karroce  
Specifikimet e kërkuara nga njësia e kërkesës janë Copy paste nga katalogu i prodhuesit Hoggi GmbH:

Specifikimet ne Katalogun e prodhuesit Hoggi GmbH pike për pike te njëjta me ato te kërkuara nga AK për pozicionin numër 1:<https://hoggi.de/en/products/rehab-pushchairs-rehab-buggies/bingo-evolution>

Pozicioni 2- pozicionin 2-Karroce me Mbështetje posturale- speciale për fëmijë aktiv,  
Specifikimet e kërkuara nga njësia e kërkesës janë Copy paste nga katalogu i prodhuesit Hoggi GmbH:

Te kërkuara nga AK:Specifikimet ne Katalogun e prodhuesit Hoggi GmbH pike për pike te njëjta me ato te kërkuara nga AK për pozicionin numër 2:<https://hoggi.de/en/products/mobility-bases/sherpa>.

Pozicioni 3- Karroca për përdorim aktiv.

Specifikimet e kërkuara nga njësia e kërkesës janë Copy paste nga katalogu i prodhuesitHoggi GmbH:

Te kërkuara nga AK: Specifikimet ne Katalogun e prodhuesit Hoggi GmbH pike për pike te njëjta me ato te kërkuara nga AK për pozicionin numër 3:<https://hoggi.de/en/products/wheelchairs/active-wheelchairs/supra-2-0>.

Ndërsa për pozicionin numër 4,5 dhe 6 specifikimet teknike janë përpiluar pike për pike për prodhuesin Invacare me seli ne Angli.

Përpilimi i specifikimeve teknike duke favorizuar prodhuesin nga Gjermania dhe prodhuesin nga Anglia nga njësia e kërkesës bie ndesh me Nenin 28 Paragrafi 2 te LPP-se ‘Autoriteti kontraktues do t’i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik’.

Përpilimi i specifikimeve teknike duke favorizuar prodhuesin nga Gjermania dhe prodhuesin nga Anglia nga njësia e kërkesës bie ndesh me Nenin 20 te RrUOPP, si:

Paragrafi 3 “Specifikimet teknike do të përshkruajnë dhe përkufizojnë, në mënyrë jo-diskriminuese, karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës, siç janë cilësia, performanca, kërkesat e dizajnit, dimensionet, siguria, sigurimi i cilësisë, terminologjia, simbolet, testimi dhe metodat e testimit, paketimi, shënimi dhe etiketimit.

Paragrafi 4 “Specifikimet /TER do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të mos paraqetkufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Ato duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë dyshime rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara.

Përpilimi i specifikimeve dhe favorizuar dhe diskriminuar prodhueses tjerë me produkte te këtyre furnizimeve, është ne kundërshtim edhe me Direktivën e BE qe e rregullon si Parim te Nenin 20të RrUOPP:

Duke ju referuar dispozitave te lartcekura dhe Nenit 7 Paragrafi 1 dhe 2 te LPP-se:

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Kërkojmë nga NJESIA E KERKESËS të SHSKUK të MODIFIKOJ ne tërësi këto specifikimeteknike te detyrueshme duke mundësuar konkurrence ne mes te prodhueseve për këtë aktivitet teprokurimit qe janë te përafërta me terma teknike qe nuk e ndryshojnë kushtin material te kërkesave minimale teknike qe janë te nevojshme për njësinë e kërkesës.

Për shkak se është procedure e hapur dhe kërkohet nga autoriteti kontraktues te mundësoj konkurrence ne mes te tenderueseve apo prodhueseve, atëherë kërkojmë nga njësia e kërkesës temodifikoj specifikimet teknike qe te na mundëson pjesëmarrjen ne këtë procedure te prokurimit si te barabarte/shtim te konkurrencës me produktet e prodhuesit Hoggi dhe Invacare

qe janë të vendosura ne dosje te tenderit respektivisht specifikimet teknike te detyrueshme aneksi 1 qe janë favorizuese për OE Madekos sh.p.k.

Njësia e kërkesës me përpilimin e specifikimeve teknike te dosjes se tenderit qe janë ne tërësifavorizuese për OE Madekos ka vepruar ne kundërshtim me Rregullat te Udhëzuesit Operativ për

Prokurimin Publik, Neni 10 Funksionet e Njesisë së kërkesës, Pika c “Siguron që nuk ka kufizime në specifikime ose term, në mënyrë që të sigurohet konkurrenca maksimale”, andaj ne këtë rast nuk ka konkurrenca maksimale por minimale apo vetëm një OE përmes prodhues te caktuar qe kemi cekur si me lartë. Duke u bazuar ne ofertat qe kemi marrur nga prodhuesit me Renome botërore rezulton se AK nëse vazhdon me kufizimin e konkurrencës duke u bazuar ne këto specifikime teknike, atëherë do te dëmtoj buxhetin e Republikës se Kosovës për 3.5 milion euro”.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Interlab” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 27, 28 të LPP-së si dhe Rregullat te Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, konkretisht neneve në vijim 10, 11, 20, 60. Duke propozuar qe ankesa të aprovohet - Ankesa si e bazuar ne tërësi. Të Modifikohen Specifikimet teknike ne atë mënyrë qe te lejohet pjesëmarrja edhe për prodhues te tjerë.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: “Përgjigje nga Njësia Kërkuese ne pretendimet e OE Ankues: Me qëllim të sigurimit të zbatimit te Udhëzimit Administrative nr. 11/2022 për përcaktimin e listës, llojeve dhe pajisjeve ndihmëse që ofrohen falas për personat paraplegjik dhe tetraplegjik që shërbejnë për lëvizje, parandalim dhe asistim.

Sigurimi ë këtyre pajisjeve të cilat do të ofrohen falas për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, do të ndihmesë e madhe në përmirësimin e kualitetit dhe ngritjen e mirëqenies te jetesës se tyre.

Ju njoftojmë që specifikat e pajisjeve në fjalë nuk janë marrë vetëm nga një prodhues, për arsyeje se fillimisht nuk përdoren vetëm nga një diagnozë e caktuar dhe nuk do të përdoren vetëm nga një person.

Pra sipas këtyre specifikave, do të mund të ofrohen karroca kualitative qe i prodhojnë disa prodhues të njohur si: B+B VVHEELCHAIR, SUNRISE MEDICAL, QUICKIE, PANTHERA, por ka dhe prodhues tjerë që kanë specifika të njëjta të cilat përputhen edhe me specifikat dhe kërkesat të cilat i kemi përshkruar e që mund të jenë edhe të adaptuara për personin i cili e përdor.

Në këtë rast specifikat teknike janë hartuar duke kombinuar karakteristikat teknike të më së paku pesë (5) prodhuesve që kanë produkte kualitative, të cilat do të jenë të përshtatura dhe të adaptuara për personat/përdoruesit e karrocave në vendin tonë. Për tua sqaruar edhe më mirë, këto pajisje/karroca mund edhe të adaptohen/përshtaten personit edhe në situatat kur personi mund të shtojë apo të humb peshë e që në këto raste, personi nuk ka nevojë për ndërrim/pranim të pajisjes tjetër. Duhet përmendur që pajisjet në fjalë, mund të përdorin në kohë më të gjatë pa pasur nevojë për riparime të shpeshta dhe gjithmonë duke u bazuar në UA i cili e përcakton edhe kohën/periudhën e dhënies së karrocës/pajisjes për një person.

Për më shumë sqarim, tek Pika 2 ku kërkohet "Specifikat e Karrocës me mbështetje posturale - speciale për fëmijë aktiv", në kuadër te Specifikimit teknik, janë së paku 17 kritere të kërkuara

për secilën prej 3 madhësive.

Ndërsa sipas referimit të cekur nga Operatori Ekonomik ku përshkruhet lloji i pajisjes vërehet qartë se kjo nuk qëndron. Pra, një krahasimin i cili mund të vërehet shumë lehtë sepse specifikacioni teknik minimal në kuadër të dosjes së tenderit dallon nga ai të cilin Operatori Ekonomik i është referuar në kërkesën e tij, kemi një dallim komplet të përshkrimit teknik. Shihet se nga 17 Pika të kërkuara për njërën prej madhësive, 16 kritere janë të kundërta nga ato të cilat i është referuar.

Pra, duke u bazuar në përvojat tona dhe kërkesat e deritanishme, konsiderojmë se këto pajisje janë ndër më të përshtatshmet dhe me të kërkuarat për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara në mënyrë që të kenë mundësinë ti përdorin për kohë më të gjatë. Gjithashtu këto pajisje siç e përmendëm edhe më lartë, kanë edhe mundësinë për tju adaptuar personit i cili e përdor, për çka kemi pasur raste të pranimit edhe të ndonjë donacioni të këtyre lloj pajisjeve të cilat kanë të cilësisë së lartë. AK-SHKUK - konsideron se kjo kërkesë për rishqyrtim është e pabazuar, dhe si të tillë refuzohet.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 16.04.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0315/24, ndërsa me datë 08.05.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0315 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimit për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ri-tenderojë.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Interlab” SH.P.K., - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0315 ka vlerësuar si në vijim:

Përshkrim i përgjithshëm i aktivitetit të prokurimit, AK me anë të këtij aktiviteti të prokurimit publik dëshiron të bëjë furnizim me 4250 copë produkte profesionale të ndryshme për personat në nevojë (paraplegjik dhe tetraplegjik), pajisje dhe produkte këto të cilat do të dorëzohen tek shoqata “Handikos”, shoqatë kjo e cila ka kërkuar nga AK që ta përshpejtoj procedurën e tenderit për shkak të nevojave të mëdha për pajisjet në fjalë.



Nga numri total i pajisjeve të kërkuara, pjesën me të rëndësishme dhe me specifike e përbejnë Karrocet speciale dhe ato standarde të cilat janë të paraqitura në pozicionet 1-8 tek përshkrimi i çmimeve, dhe ndaj disa prej tyre janë edhe të drejtuara pretendimet ankimore nga OE ankues.

Ankesa është e drejtuar kundër kriterëve diskriminues në specifikacionin teknik dhe pretendimet e OE ankues për favorizime të prodhuesve të caktuar, rrjedhimisht kufizimin e konkurrencës dhe barazisë në ofertim të OE konkurrues!

Eksperti shqyrtues teknik pas analizimit të pretendimeve ankimore, fakteve të paraqitura, shqyrtimit të detajuar të ankesës, kërkesës për rishqyrtim dhe vendimit mbi kërkesën për rishqyrtim si dhe duke u bazuar në analizimin e vegzave të paraqitura në ankesë, pastaj në emrat e prodhuesve dhe produkteve të cekura, si dhe hulumtimin e përgjithshëm në internet, ka arritur të gjejë arsyetime të mjaftueshme për tu përgjigjur në të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues dhe në fund të nxjerrë rekomandimet për Panelin Shqyrtues të OSHP-së, në përputhje me mundësitë dhe kompetencat e tij ligjore të cilat ia ofronë LPP.

Në ankesën e OE ai pretendon se gjatë udhëheqjes së këtij aktiviteti e deri në momentin e ankesës në OSHP, AK ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 27 dhe 28 të LPP-së dhe me nenet: 10.1 c, 11.1 c, 20 dhe 69 të rregullores nr. 001-2022 për prokurim publik.

Pretendimi Ankimor 1, ka të bëjë me shkurtimin e afateve kohore për dorëzimin e ofertave nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

Përgjigja e ekspertit shqyrtues teknik në pretendimin 1: Lidhur me pretendimin ankimor për shkurtimin e afateve kohore, dua të ceku se AK këtë aktivitet nuk e ka të paraparë në Planin e prokurimit të publikuar në: <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=327>, e po ashtu eksperti shqyrtues teknik në platformën “e-prokurimi” nuk ka mundur të gjejë njoftimin paraprak i cili është obligativ për tenderët me vlerë të madhe në përputhje me nenin 39 të LPP-së. Andaj arsyetimin e AK-së për nevojën urgjente dhe kërkesën e shoqatës “Handikos” për tu pajisur me këto pajisje e shoh si të pa arsyeshme dhe të panevojshme për mos respektim të procedurave të parapara ligjore.

AK përpos që ka shkurtuar kohën e dorëzimit të ofertave, ka kërkuar nga OE konkurues që para dorëzimit të ofertave të i dërgojnë edhe mostrat:

Kërkesë për mostra edhe mund të arsyetohet, nëse do të ishin respektuar procedurat obligative për këto lloje të aktiviteteve të prokurimit, duke i njoftuar paraprakisht OE konkurues dhe duke ju krijuar kushte dhe afat kohor të mjaftueshëm për përgaditje. Gjithashtu mendoj është dashur të kërkohej mostrat edhe për produktet 1, 2, 4 dhe 5 nga lista e çmimeve, pasi që për mendimin tim janë shumë me të rëndësishme dhe si produkte janë me të kushtueshme dhe me të komplikuar.

Andaj propozoj që ky pretendim ankimor të aprovohet si i bazuar nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së.

Pretendimi Ankimor 2, me përshtatjen e specifikave teknike të produkteve 1, 2 dhe 3 dhe produktet 4, 5 dhe 6, nga dokumenti “përshkrimi i çmimeve”, për produktet e prodhuesve “Hoggi dhe Invacare”. Konkretisht nga Aneksi 1 të FDT, produktet si në vijim:

Produkti të pozicioni 1: (Karrocë me mbështetje posturale - speciale për fëmijë të varur 100% në karrocë): Favorizuese për prodhuesin HOGGI GmbH dhe modelin Bingo evolution;

Produkti te pozicioni 2: (Karrocë me mbështetje posturale - speciale për fëmijë aktiv)–: për prodhuesin HOGGI GmbH dhe modelin Sherpa 3007;

Produkti te pozicioni 3: (Karroca për përdorim aktiv): për prodhuesin HOGGI GmbH dhe modelin Supra 2.0; Produktet tek pozicionet 4, 5 dhe 6: për prodhuesin Invacare nga Anglia.

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues teknik ne pretendimin 2: “Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimet ankimore te OE ankues se AK i ka përshtatur specifikat e produkteve të cekura për prodhuesit dhe produktet përkatëse, i ka kontrolluar dhe analizuar te njëjtat duke i krahasuar me katalogët dhe informacionet të cilat ka mundur ti gjejë në internet e po ashtu edhe i kam kontrolluar edhe prodhuesit e cekur nga ana e njësisë kërkues të AK-së në arsyetimin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim të OE ankues, si në vijim:

Sa i përket pretendimit për pozicionin 1: (Karrocë me mbështetje posturale - speciale për fëmijë të varur 100% në karrocë), i cili sipas pretendimit te OE ankues ka specifika favorizuese për prodhuesin HOGGI GmbH dhe modelin Bingo evolution, eksperti shqyrtues ka hulumtuar në internet, konkretisht: <https://hoggi.de/en/products/rehab-pushchairs-rehab-buggies/bingo-evolution> i cili produkt apo si emërtim është gjenerik, kurse si produkt është i modifikueshëm, gjë që ceket edhe në webfaqen e prodhuesit;

Më poshtë në të njëjtën vegëz, shihen edhe specifikat e produktit, dhe të cilat nëse krahasohen me ato të publikuara nga AK, përpos që janë të përkthyer dhe përshtatura në gjuhën shqipe, dhe i është shtuar kolona me emërtime sipas shkronjave te mëdha të Alfabetit: A, B, C ... janë identike me produktin e cekur në ankesën e OE.

Katalogu për këtë produkt, me qëllim të krahasimit, mund të shkarkohet në këtë vegëz dhe atë në gjuhën angleze: <https://hoggi.de/en/downloads/category/131-bingo-evolution>.

Sa i përket pretendimit që produkti 2 në përshkrimin e çmimeve: (Karrocë me mbështetje posturale - speciale për fëmijë aktiv)–: është përshtatur për prodhuesin HOGGI GmbH dhe modelin Sherpa 3007. Eksperti shqyrtues teknik për produktin Sherpa të këtij prodhuesi ka gjetur informata në web faqën e prodhuesit, në vijim vegza: <https://hoggi.de/en/products/wheelchairs/tilt-wheelchairs/sherpa>

Variacionin e këtij produkti të cilit i është referuar OE ankues, konkretisht Sherpa 3007, e kam gjetur në verzionin në gjuhën gjermane, dhe po i paraqes disa nga specifikat kryesore:

Të cilat nëse i krahason më specifikat minimale të kërkuara nga AK ne Aneksin 1, që janë si në vijim: Vërehet që në këtë rast OE “nuk e ka qëlluar produktin”, gjegjësisht produkti Sherpa 3007 nuk është produkti të cilit “AK i’a ka përshtatur specifikat”, sepse përpos kolonës së parë, të dhënat tjera janë të ndryshme nga ato të paraqitura në pjesën e katalogut dhe në vegzen e mësipërme.

Por megjithatë kjo nuk do të thotë që OE konkurrent të mos bëjnë kërkesa për sqarime dhe përmes tyre “të hapin mundësitë” e ofertimit me produkte ekuivalente, pa e humbur kualitetin dhe funksionalitetin e kërkuar të produkteve të ofertuara, por vetëm duke e rritur konkurrencën e lirë!

Sa i përket pretendimit që produkti te pozicioni 3: (Karroca për përdorim aktiv) është përshtatur për prodhuesin HOGGI GmbH dhe modelin Supra 2.0; Nga AK janë kërkuar 500 copë karroca të



tilla. Kurse në Aneks 1 janë te cekura 100 copë M; 100 copë L dhe 200 copë karroca të madhësisë XL, pra në total 400 copë, duhet ta përmirësojnë sasinë totale.

Eksperti shqyrtues teknik ka hulumtuar ne web faqen e prodhuesit Hoggi GMBH dhe ka hasur të produkti i cituar në ankesën e OE ankues, konkretisht në vegzën, të cilën po e bashkëngjis në vijim: <https://hoggi.de/en/products/wheelchairs/active-wheelchairs/supra-2-0>

Këtu janë specifikat dhe përshkrimi i produktit, ku nëse krahasohen me specifikat minimale të kërkuara nga AK për produktin në pozicionin 3 tek Aneksi 1, kemi specifika identike me atë të supozuar nga OE ankues, e që janë identike shihet që rreshti ku ne webfaqe janë informatat për verzionin e Karrocës “Seat width (SUPRA 2.0 Abdu)” janë mbete të zbrazëta në tabelën e Aneksit 1. Shih në vijim:

Nga Aneksi 1: Eksperti shqyrtues teknik propozon qe ky pretendim ankimor të aprovohet si pjesërisht i bazuar. AK në përgjigjen e tyre në kërkesën për rishqyrtim kanë cekur edhe disa prodhues nga produktet e të cilëve i kanë krijuar specifikacionët teknike te publikuara në Aneksin 1. Dhe atë si në vijim: Eksperti shqyrtues teknik ka hulumtuar në internet dhe ka hasur ne informacione për keta prodhues: <https://en.bischoff-bischoff.com/>; <https://www.sunrisemedical.com/>; <https://www.quickiewheelchairs.com/>; [https://www.panthera.se/en/produkter\\_en.html](https://www.panthera.se/en/produkter_en.html)

Tek prodhuesi gjerman: “B and B”, <https://en.bischoff-bischoff.com/products/manual-wheelchairs/>, nuk kam hasur në karroca te dedikuara për femijë siq është kërkesa konkrete për pozicionet 1 dhe 2 te Aneksit 1 dhe këto produkte vetëm gjerësinë e ulëses e kanë të modifikueshme.

Tek prodhuesi amerikan: “Sunrise Medical”: <https://www.sunrisemedical.com/manual-wheelchairs/zippie>, ka produkte të dedikuara për femijë me nevoja te veçanta, shihet edhe nga katalogu si në vegzen në vijim: <https://www.sunrisemedical.com/getattachment/f7b0cae3-53db-4974-8501-85054a8ae64a/>.aspx, por jo me specifika te detajuara siç janë të paraqitura në Aneksin 1 të dosjes se tenderit dhe janë kërkuar nga AK. Por me dimensione dhe karakteristika tjera të modifikueshme.

Tek prodhuesi: “Quickie”, i cili është pjesë e grupit “Sunrise Medical”, <https://www.quickiewheelchairs.com/>, mund te krahasohen produktet e kërkuara për pozicionet 1 dhe 2, sepse ekziston kategoria e karrocave me rrota, manuale pediatrike <https://www.quickiewheelchairs.com/Pediatric-Wheelchairs/549c0>

Tek prodhuesi suedez: “Panthera” [https://www.panthera.se/en/produkter\\_en.html](https://www.panthera.se/en/produkter_en.html), në web faqen e tyre nuk kam mundur të gjejë karroca manuale qe i’u pershtaten kërkesave dhe karakteristikave teknike të kërkuara për 3 produktet e para në listen e çmimeve. Karrocat e ekspozuara, po ashtu janë të modifikueshme, por me të thjeshta, pra karrocat e këtij prodhuesi janë me të thjeshta dhe nuk mund te krahasohen me produktet e kërkuara nga AK.

Përpos këtyre prodhuesve të cilëve i’u është referuar AK në përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim, eksperti shqyrtues teknik gjatë hulumtimit në internet ka hasur edhe në disa webfaqe tjera të cilat ofrojnë produkte të ngjajshme: [www.adaptivemall.com](http://www.adaptivemall.com); [www.specialtomato.com](http://www.specialtomato.com); <https://medifab.com/> etj. Të cilat mund të i’u shërbejnë si OE ashtu edhe AK-së për të shikuar mundesimin e ofrimit të variacionëve dhe prodhimeve të ndryshme të këtyre produkteve.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, mendoj qe OE ankues ka patur te drejtë për referimin nga ana e AK-së të produkteve specifike për pozicionët 1 dhe 3 të Aneksit 1, por mendoj gjithashtu qe ka shumë prodhues të karrocave specifike të cilat mund të ofrojnë produkte të ngjajshme me këto të kërkuarat.

Eksperti shqyrtues teknik nuk ka mundur të gjejë ndonjë kërkesë për sqarime të berë nga OE, lidhur me kufizimet e supozuara të bëra nga AK dhe mundësitë e ofrimit të produkteve alternative/ekuivalente me ato të kërkuarat, andaj mendoj qe me anë të kërkesave për sqarime duhet të hapen mundësitë për aplikim me variante të produkteve e jo kufizime.

Gjithashtu e ceku se askund në dosje nuk janë të cekura termet “ekuivalente/te ngjajshme/të përafërta” etj. Dhe kjo të krijon përshtypje të kufizimit të konkurrencës.

Sa i përket pjesës së pretendimit që produktet tek pozicionet 4, 5 dhe 6 janë përgaditur apo janë specifika të marra/përshtatura për prodhuesin “Invacare” nga Anglia.

Eksperti shqyrtues teknik ka hulumtuar në internet dhe i ka krahasuar specifikat minimale të kërkuara nga AK dhe të paraqitura në Aneksin 1 me produktet të cilat ky prodhues i prodhon <https://www.invacare.co.uk/products>.

AK në aneksin 1 dhe tek përshkrimi i çmimeve për këto pozicione ka kërkuar:

Në pozicionin 4 AK ka kërkuar 80 copë: Karroca standarde me 4 rrota të vogla për tetraplegjik;

Në pozicionin 5 AK ka kërkuar 300 copë: Karroca standarde për fëmijë dhe të rritur;

Në pozicionin 6 AK ka kërkuar 100 copë: Karroca elektrike Standarde.

Tek pozicioni 4, sasia totale e kërkuar është 80 copë kurse në varësi nga gjerësia e ulësës janë kërkuar 200 copë, pra duhet të korrigjohet sasia nga AK njëjtë sikur tek produkti paraparak.

Për produktin 4, tek webfaqja e prodhuesit të cituar nga ana e OE ankues, ka produkte të ngjajshme: <https://www.invacare.co.uk/manual-wheelchairs/tilt-space-wheelchairs/rea-dahlia-manual-wheelchair#highlights>, por asnjëra nga produktet nuk i kanë specifikat identike me ato të kërkuara nga AK në Aneksin 1, por janë si të ngjashme, me specifike apo dalluese, ndër të tjera janë: pesha maksimale e bartjes e cila nuk është e njëjtë me asnjërin produkt në webfaqen e prodhuesit të cituar, po ashtu dimensionet e rrotave që kërkohen nga AK, nuk janë askund të specifikuara në web faqen e prodhuesit.

Mendoj që AK me përshkrimin e specifikave për produktin 4 të Aneksit 1, me aq sa kam mundur të analizoj dhe krahasoj unë, nuk i'u ka referuar asnjërit produkt të prodhuesit anglez “Invacare”.

Sa i përket produktit në pozicionin 5 “Karroca standarde për fëmijë dhe të rritur”. Eksperti teknik ka hulumtuar në webfaqen e prodhuesit të cituar në ankesën e OE, i ka kontrolluar specifikat e produkteve që i përshtaten përshkrimit të dhënë në specifikacionin teknik, Aneksi 1 të cilat mund të konfirmohen në këtë vegëz: <https://www.invacare.co.uk/manual-wheelchairs/low-active-wheelchairs>, nëse krahasohen dy produkte të cilat iu përshtaten kërkesës së AK-së, e që mund të analizohet në vegëzën <https://www.invacare.co.uk/products/compare> me specifikat minimale teknike në Aneksin 1, mund të vërehen lehtësisht që janë të përafërta e jo identike me kërkesat minimale teknike. Andaj pretendimi ankimor i OE ankues për këtë pozicion nuk është i bazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor për pozicionin 6, ku AK ka kërkuar 100 copë: Karroca elektrike Standarde, dhe pretendimin ankimor që specifikat e të cilave u'a ka përshtatur produkteve të prodhuesit "Invacare". Eksperti shqyrtues teknik i ka kontrolluar dhe krahasuar produktet të cilat gjenden ne webfaqen e prodhuesit dhe të cilat i përkasin apo kane karakteristika teknike dhe funksionale te ngjashme me përshkrimin e dhënë nga AK ne Aneksin 1, dhe ka ardhur në këto konstatime qe këto produkte të këtij prodhuesi mund të gjinden për krahasim në këtë vegëz: <https://www.invacare.co.uk/power-wheelchairs-mobility-scootersalber>.

Eksperti shqyrtues teknik i ka krahasuar së pari në mes vete produktet që ky prodhues i ofron dhe i ka të prezantuar ne webfaqen e tyre, <https://www.invacare.co.uk/products/compare>, e pastaj të njëjtat i ka krahasuar me specifikat e paraqitura ne Aneksin 1.

Nga krahasimet e bëra eksperti shqyrtues teknik konstaton se produktet e kësaj familje të prodhuesit Anglez "Invacare" janë me të avancuara se sa ato të kërkuara nga AK dhe që specifikat teknike të paraqitura në Aneksin 1 për produktin në pozicionin 6, nuk janë të kopjuara, sipas pretendimit ankimor, nga ky prodhues. Andaj konstatoj se ky pretendim ankimor të konsiderohet si i pabazuar nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së.

Përmbyllje e ekspertizës : "Përpos produkteve të kërkuara në pozicionet 1 dhe 3 të cilat janë identike me produktet e prodhuesit të cekur në ankesë e OE ankues, janë në kundërshti me nenin 28 të LPP-së, produktet tjera te pretenduara, janë të përafërta me produktet e cituara, e jo identike siç janë pretendimet ankimore. Si përfundim propozoj që ankesa e OE të aprovohet si pjesërisht e bazuar, AK të bejë modifikim e specifikave teknike duke shtuar tekstin siç janë: Kërkesat minimale të lejuara, ekuivalente etj. me anë te të cilave dhe po ashtu edhe përmes kërkesave për sqarime (duke iu dhenë kohë të mjaftueshme OE për të parashtruar të njëjtat) të ofron mundësi konkurrimi të shumë OE dhe gjithmonë duke e mbajtur dhe duke u siguruar qe përmes certifikatave specifike të kërkuara dhe deklaratave të garancionit, të cilat propozoj qe të mbesin të njëjtat, të furnizohen me produkte të kualitetit me të mirë të mundshëm.

Duke u bazuar në analizën, krahasimet, shqyrtimet e pretendimeve ankimore nga ana e ekspertit teknik te përcaktuar nga OSHP, me kërkesë te ekspertit shqyrtues ne rastin konkret dhe rrjedhës së përgjithshme të këtij aktiviteti të prokurimit publik, eksperti shqyrtues duke u bazuar ne raportin dhe analizën e pretendimeve ankimore te shtjelluara si me lartë nga eksperti teknik, i propozonë Panelit Shqyrtues të OSHP-së që ankesën ta aprovonjë si pjesërisht të bazuar, të sjellin vendim obligativ për AK-në, për modifikimin e specifikimeve teknike te produkteve të cekura në këtë ekspertizë dhe sasive të parapara, duke krijuar mundësi të barabarta për OE, ofertues potencial, për pjesëmarrje dhe ofertim në pajtim me LPP-në dhe aktet nënligjore që e rregullojnë këtë fushë.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas

të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është nuk është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim, me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Furnizim me produkte për personat paraplegjik dhe tetraplegjik” me nr. të prokurimit: 00220-24-2499-1-1-1. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshtatshmërinë dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, veprimet dhe përgjigjet e AK qoftë në përgjigje të kërkesës për ri-shqyrtim po ashtu edhe përgjigjet e AK në raportin e ekspertit duke bërë thirrje që ekspertiza është e hartuar në mënyrë jo profesionale , kundërtëse dhe pa prova.

Andaj, Paneli shqyrtues duke analizuar të gjithë këtë dokumentacion sa i përket këtij aktiviteti të prokurimit: Furnizim me produkte për personat paraplegjik dhe tetraplegjik dhe numer të prokurimit: 00220-24-2499-1-1-1, dhe duke e marrë parasysh se kemi të bëjmë me një ekspert teknik me të gjeturat e tij, karshi AK që ka një mekanizëm i cili përbëhet prej njësisë së kërkesës e cila duhet të jetë e përbërë prej një grumbull specialistësh dhe profesionistësh dhe është përgjegjëse të vendos kritere specifike të cilat duhet të jenë relevante me natyrën e aktivitetit dhe nevojat për një furnizim adekuat dhe të përdorshëm sipas nevojave të tyre, si dhe duke marrë parasysh natyrën e ndjeshme për një katekori të personave me nevoja të veçanta, atëherë, Paneli Shqyrtues pa pasur nevojë të përmend secilin pretendim ankimor i cili është i paraqitur në raport të ekspertizës, vendos tja fal besimin në këtë rast AK, përfshirë edhe njësisë së kërkesës e cila në përgjigje të kërkesës për ri-shqyrtim më dt. 08.04.2024, ka deklaruar se këto specifika nuk janë në kundërshtim me LPP dhe kanë për qëllim edhe të sigurimit të zbatimit të udhëzimit administrativ nr. 11/2022 për përcaktimin e listës, llojeve dhe pajisjeve ndihmëse që ofrohen falas për personat paraplegjik dhe tetraplegjik që shërbejnë për lëvizje, parandalim dhe asistim, dhe si të tilla sipas këtyre specifikave do të mund të ofrohen karroca kualitative që i prodhojnë disa prodhues të njohur, përfshirë 5 prodhues që kanë produkte kualitative dhe të qëndrueshme për një kohë të gjatë.

Lidhur me këtë, Paneli, shpjegon po ashtu se Autoriteti Kontraktues (AK), në kuptim të nenit 1 dhe 6 dhe në përputhje me nenin 115 të Ligjit për Prokurim Publik, nga cilësia e saj si iniciuese e këtij aktiviteti të prokurimit, kishte mundësinë të rishikonte sërish kërkesat e DT, bazuar në gjetjet e ekspertit shqyrtues. Ku, Ligji specifikon se nëse AK vërteton se pretendimi ose të gjitha pretendimet janë të vlefshme dhe nuk janë refuzuar nga ankuesi, ata mund të ndërmarrin veprime korrigjuese të rekomanduara nga eksperti. Megjithatë, edhe në këtë rast, AK ka vazhduar të refuzojë raportin e ekspertit.

Si rrjedhoj, Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit, ka vendosur që të lë në fuqi njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e “Furnizim me produkte për personat paraplegjik dhe tetraplegjik” me nr. të prokurimit: 00220-24-2499-1-1-1, dhe AK të vazhdoj tutje me aktivitetin e prokurimit, me çrast secili OE ka mundësi të hulumtoj tregun të gjej prodhues dhe të ofertoj konform specifikave të AK të vendosura për këto pajisje, ngase është fakt i ditur se asnjëri OE vendas që do të bëjë furnizim e tyre nuk është edhe prodhues.

PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e produkteve që plotësojnë nevojat adekuatë të tyre, si dhe pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet.

Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse. Andaj, AK është përgjegjëse edhe për hartim të DT, sipas nenit 27 dhe 28 të LPP.

Paneli Shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të pjesërishëm të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP. Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit. Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS**
- **OE - Interlab SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: